

REPUBLICA E KOSOVES - REPUBLIKA KOSOVA
KOMUNA E FUSHË-KOSOVËS - OPŠTINA KOSOVO-POLJE
DIREKTORIA E ADMINISTRATËS - DIREKCIJA ZA ADMINISTRACIJO

Refaq/Refst. 1584
Data/Datum. 27 07 2026
KOMUNA E FUSHË-KOSOVËS - OPŠTINA KOSOVO-POLJE



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA



KOMUNA E FUSHË-KOSOVËS / OPŠTINA KOSOVO-POLJE
MUNICIPALITY OF FUSHË-KOSOVË/KOSOVO-POLJE

Datë: 27.07.2026

Komuna e Fushë Kosovës, bazuar në nenin 68, paragrafi 3, të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale Nr. 03/L-040 (Gazeta Zyrtare Nr. 28/2008), nenin 17, paragrafi 1, nën - paragrafi 1.2, nenin 19, nenin 21, nenin 22, paragrafi 1, nën - paragrafi 1.2, nenin 28, të Udhëzimit Administrativ të Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal Nr. 04/2023 për Administratë të Hapur në Komunë, nenin 17, paragrafi 17.1, shkronja (ç, ë) të Statutit të Komunës së Fushë-Kosovës Nr. 98, të datës 17.08.2012, vendimin e Kuvendit të Komunës Nr. 189, të datës 02.06.2026 shpallë këtë:

N J O F T I M

Për konsultim publik për Projekt-Rregullores për lëshimin e lejeve për vendosjen e paneleve foto-voltaikë në territorin e Komunës së Fushë-Kosovës

Njoftimi për konsultim publik lidhur me 'Projekt-Rregullores për lëshimin e lejeve për vendosjen e paneleve foto-voltaikë në territorin e Komunës së Fushë-Kosovës', është i hapur nga data: **27.07.2026 deri më datën 10.08.2026.**

Projekt-Rregullorja për lëshimin e lejeve për vendosjen e paneleve foto-voltaikë në territorin e Komunës së Fushë-Kosovës, është e publikuar në ueb-faqen zyrtare të Komunës së Fushë-Kosovës

Komentet, sugjerimet apo vërejtjet lidhur me projekt-aktin normativ, mund t'i adresoni përmes adresave elektronike si vijon: taulant.she.kelmendi@rks-gov.net dhe hasan.gjyrevci@rks-gov.net

Komuna e Fushë-Kosovës e ka paraparë edhe një takim të Konsultimit Publik, i cili do të mbahet me datën: **06.08.2026, me fillim prej orës 15:00h** në Sallën e Kuvendit të Komunës së Fushë-Kosovës.

Me respekt,

**Kryetari i Komunës
Valon Prebreza**





REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA
KOMUNA E FUSHË-KOSOVËS / OPŠTINA KOSOVO POLJE
MUNICIPALITY OF FUSHË KOSOVË



Nr.

Date: _____.2026

**Projekt-Rregullore Komunale për lëshimin e Lejes për instalimin e paneleve
fotovoltaike**

Në bazë të nenit 11 dhe nenit 12. paragrafit 2 pika (c.) të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale (Ligji nr. 03/L-040), nenit 19 paragrafi 2, Nenit 35 të Ligjit për Ndërtim (Ligji nr. 04/L- 110), si dhe nenit 13.paragrafi 13.6 shkronja [c] e Statutit të Komunës së Fushë Kosovës nr. 98, të datës 17.08.2012 Kuvendi Komunal Fushë Kosovë e miraton këtë:

Rregullore për lëshimin e Lejes për instalimin e paneleve fotovoltaike

I. DISPOZITAT E PËRGJITHSHME

Neni 1

Qëllimi dhe fushëveprimi

1. Qëllimi i kësaj Rregullore është të përcaktojë procedurën dhe kriteret për dhënien e Lejes për Instalimin e paneleve fotovoltaike për vetë konsum për persona fizik dhe juridik.
2. Kjo Rregullore përcakton rregullat, procedurat , kriteret, si dhe procedurat administrative gjatë procesit të vendimmarrjes nga Komuna për dhënien e Lejes për instalimin e paneleve fotovoltaike për prodhimin e energjisë elektrike për vetë konsum për personat fizik apo juridik.
3. Kjo rregullore nuk zbatohet edhe për vendosje ne çati te paneleve solarë për prodhim te energjisë elektrike për vet konsum, që janë konsumator fizik me kapacitete te instaluar deri ne 7 kW te cilët janë të liruar nga Leja sipas U.A me Nr.15/2023 për ndryshim dhe plotësim me U.A. 08/2023 MMPHI.
4. Kjo Rregullore nuk zbatohet për instalimin e paneleve fotovoltaike për vetëkonsum në tokë bujqësore.
5. Leja për instalimin e paneleve fotovoltaike për vetëkonsum, e lëshuar sipas kësaj Rregullore, nuk nënkupton dhe nuk zëvendëson autorizimin për ndërtim i cili lëshohet nga Zyra e Rregullatorit për Energji dhe nuk nënkupton se janë përmbushur kërkesat teknike të paraqitura nga operatori i sistemit të shpërndarjes të energjisë elektrike. Leja për instalimin e paneleve fotovoltaike për vetëkonsum lëshohet vetëm për qëllime të aplikimit nga ana e Aplikuesit pranë Zyrës së Rregullatorit për Energji për marrjen e Autorizimit për ndërtim të kapaciteteve të reja gjeneruese për vetë konsum.

Neni 2

Përkufizimet

1. Përkufizimet e përdorura në këtë Rregullore janë si më poshtë:
 - 1.1. Autorizim për ndërtim – nënkupton dokumentin e lëshuar nga Zyra e Rregullatorit për Energji në bazë të cilit Aplikuesi mund të filloj ndërtimin e kapaciteteve të reja gjeneruese për vetëkonsum;

- 1.2. [DPUMM-Drejtoria për Planifikim Urban dhe Mbrojtjen e Mjedisit¹];
- 1.3. [Udhëheqës i DPUMM - -Drejtoria për Planifikim Urban dhe Mbrojtjen e Mjedisit;]
- 1.4. Rregullore - nënkupton Rregulloren për lëshimin e Lejes për instalimin e paneleve fotovoltaike për vetë-konsum (Nr.) e cila përcaktohen rregullat dhe procedurat për dhënien e Lejes për instalimin e paneleve fotovoltaike për vetëkonsum;
- 1.5. Ministria - nënkupton Ministrinë përgjegjëse për sektorin e ndërtimit;
- 1.6. Komuna - nënkupton njësinë bazë të vetëqeverisjes lokale në Republikën e Kosovës;
- 1.7. Leje për instalimin e paneleve fotovoltaike për vetëkonsum – nënkupton dokumentin me të cilin Komuna e [XXXXXXX] miraton kërkesën e Palës për instalimin e Paneleve fotovoltaike për prodhimin e energjisë elektrike për vetëkonsum ;
- 1.8. Palë/Aplikuesi - nënkupton personin fizik dhe juridik, në emër të të cilëve zhvillohet procedura për dhënien e Lejes për instalimin e paneleve fotovoltatike, përkatësisht pronari, poseduesi ose investitori i cili i shfrytëzon të drejtat në pronën e paluajtshme për instalimin e paneleve fotovoltatike;
- 1.9. Projekt - nënkupton planet, vizatimet, planimetritë, përshkrimet për kryerjen e punëve ndërtimore, instalimeve apo punimeve elektrike, apo punëve tjera për instalimin e paneleve fotovoltaike;
- 1.10. Panele fotovoltaike – nënkupton panelet fotovoltaike përmes së cilave energjia diellore shndërrohet në energji elektrike;
- 1.11. Vetëkonsum – nënkupton prodhimin e energjisë elektrike përmes paneleve fotovoltaike nga konsumatori i energjisë elektrike, në të njëjtën kohë edhe prodhues i energjisë elektrike, për nevoja vetanake. Konsumatori vetkonsumues energjinë e prodhuar nga panelet fotovoltaike e plasojnë në rrjet elektrik për konsum të mëvonshëm në përputhje me skemën mbështetëse të aprovur nga Zyra e Rregullatorit për Energji.

II. PROCEDURA PËR LËSHIMIN E LEJES PËR INSTALIMIN E PANELEVE FOTOVOLTAIKE PËR VETË-KONSUM

Neni 3

Autoriteti kompetent

Organi kompetent për zhvillimin e procedurës dhe për dhënien e Lejes për instalimin e paneleve fotovoltaike për vetëkonsum është Komuna e Fushë Kosovës, përkatësisht *Drejtoria për Planifikim Urban*.

Neni 4
Instalimi i paneleve fotovoltaike për vetëkonsum

1. Leja për instalimin e paneleve fotovoltaike për vetëkonsum lëshohet për:
 - 1.1. Objektet që kanë leje ndërtimi, dhe
 - 1.2. Objektet që janë në proces të legalizimit.
2. Leja për instalimin e paneleve fotovoltaike për vetëkonsum, për objektet nga Neni 4, paragrafi 1.1 dhe 1.2, lëshohet vetëm për instalin të paneleve fotovoltaike për vetëkonsum të instaluar në sipërfaqe të ndërtuara.

Neni 5
Procedura e Aplikimit

1. Për marrjen e Lejes për instalimin e paneleve fotovoltaike për vetëkonsum, Aplikuesi duhet të paraqesë kërkesë në Komunë, pranë *Drejtoria për Planifikim Urban* të cilës i bashkëngjiten dokumentet e mëposhtme:
 - 1.1. Aplikimi/Kërkesa;
 - 1.2. Fletëpagesa ;
 - 1.3. Kopja e dokumentit të identifikimit personal e Aplikuesit ose certifikatës së regjistrimit të biznesit për bizneset ;
 - 1.4. Fleta poseduese;
 - 1.5. Kopje e planit me koordinata;
 - 1.6. Përshkrimi teknik i Projektit (statik), duke përfshirë edhe projektin elektrik;
 - 1.7. Pëlqimin mjedisor për kapacitete prodhuese mbi 100 KW/ore e lëshuar nga Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapsinore,
 - 1.8. Lejen mjedisore Komunale për kapacitete prodhuese deri në 100Kw /ore,
 - 1.9. Nëse Aplikuesi nuk është pronar ligjor, një kontratë për shfrytëzimin e ngastrës ose dëshmi se ka titull ligjor për të shfrytëzuar pronën.

2. Në rastet kur objekti, në të cilin propozohet të instalohen panelet fotovoltaike, nuk posedon leje ndërtimi, Aplikuesi përveç dokumenteve nga Neni 5, paragrafi 1, paraqet edhe dokumentacionin e mëposhtëm:
 - 2.1. Dëshmi se Aplikuesi ka iniciuar procesin për legalizimin e objektit;
 - 2.2. Një deklaratë me shkrim nga Aplikuesi se:
 - 2.2.1. objekti i plotëson të gjitha standardet teknike, elektrike dhe standardet e ndërtimit, të nevojshme për instalimin e paneleve fotovoltaike;
 - 2.2.2. merr përsipër çdo pasojë në rast të shkaktimit të dëmit si rrjedhojë e vendosjes së paneleve fotovoltaike në objektin i cili nuk posedon Leje Ndërtimi.
3. Aplikimi/kërkesa bëhet sipas formularit të paraqitur në Aneksin 1 të kësaj Rregullore.

Neni 6

Përmbajtja e Lejes

1. Leja për instalimin e paneleve fotovoltaike për vetëkonsum përmban informatat në vijim:
 - 1.1. Emri i Aplikuesit të cilit i është dhënë Leja për instalimin e paneleve fotovoltaike për vetëkonsum;
 - 1.2. Përshkrimi i lokacionit/objektit ku do të instalohen panelet fotovoltaike (numri i njësisë kadastrale, fleta poseduese, adresa, etj);
 - 1.3. Përshkrimi teknik i projektit (p.sh. kapaciteti dhe sipërfaqja, etj.);
 - 1.4. Afati i vlefshmërisë së Lejes për instalimin e paneleve fotovoltaike për vetë-konsum, sipas nenit 10 më poshtë.

Neni 7

Taksat

1. Aplikuesi në momentin e dorëzimit të Aplikacionit dorëzon edhe dëshminë e pagesës së taksës për shqyrtim të aplikacionit në vlerë prej pesëdhjetë (50) Euro.

2. Nëse aplikues është organizatë publike si shkollat, qendra te mjekisë familjare, kulturorë, sportivë e te ngjashëm lirohet nga pagesa e taksës .
3. Pagesa e taksës për shqyrtim të Aplikacionit nuk rimbursohet në rast të refuzimit të dhënies së Lejes për instalim të paneleve fotovoltaike.

Neni 8

Afati për lëshim të Lejes

1. Zyrtari përgjegjës pranë *Drejtorisë për Planifikim Urban* në afat kohor 30 (tridhjetë) ditore nga dita e pranimit të kërkesës për Leje për instalimin e paneleve fotovoltaike për vetëkonsum do të shqyrtoj kërkesën dhe të vlerësojë arsyet për miratimin ose refuzimin e kërkesës dhe do të nxjerr vendimin përkatës.
2. Në rast të lëshimit të Lejes për instalimin e paneleve fotovoltaike për vetë konsum për objekte të cilat nuk posedojnë leje ndërtimore, lëshimi i Lejes për instalimin e paneleve fotovoltaike nuk përbën asnjë argument në favor të legalizimit, nuk paragjykon statusin përfundimtar të procesit të legalizimit, si dhe nuk themelon asnjë të drejtë tjetër përveç qëllimit thelbësor të saj për instalimin e paneleve fotovoltaike për prodhimin e energjisë elektrike për vetë konsum.

Neni 9

E drejta në Ankesë

1. Në rast të refuzimit të kërkesës për marrjen e Lejes për instalimin e paneleve fotovoltaike për vetëkonsum, Aplikuesi, në cilësi të palës së pakënaqur, ka të drejtë të parashtrojë ankesë pranë Zyrës së Kryetarit të Komunës brenda tridhjetë (30) ditëve nga data e marrjes së Vendimit.
2. Shqyrtimi i ankesës bëhet nga *Komisioni për ankesa* i themeluar nga Zyra e Kryetarit të Komunës brenda tridhjetë (30) ditëve nga data e dorëzimit të saj.
3. Pala e pakënaqur me vendimin për shqyrtimin e ankesës mund të iniciojë kundërshtim administrativ pranë Gjykatës kompetente në përputhje me Ligjin (Nr. 05/L-031) për Procedurën e Përgjithshme Administrative.

Neni 10

Vlefshmëria e Lejes

1. Vlefshmëria e Lejes për instalimin e paneleve fotovoltaike për vetëkonsum është një (1) vit nga momenti i lëshimit të saj nga organi përgjegjës.

2. Leja mund të ndërpritet edhe më herët në rast se:

- 2.1. mbajtësi i Lejes nuk fillon zbatimin e projektit brenda një (1) viti; dhe nuk paraqet kërkesë për vazhdimin e saj sipas pikës (2.3) më poshtë
 - 2.2. mbajtësi i Lejes nuk i plotëson kushtet e përcaktuara me Lejen për instalimin e paneleve fotovoltaike për vetëkonsum, nëse ka, dhe
 - 2.3. mbajtësi i Lejes brenda afatit të caktuar, nuk vepron sipas udhëzimeve të Inspektorit përkatës, ose nuk ndërmerr masat e kërkuara nga inspektorët.
3. dy (2) muaj para skadimit të afatit të Lejes, sipas Nenit 10, paragrafi 1, mbajtësi i Lejes i cili dëshiron të vazhdojë vlefshmërinë e Lejes, duhet të paraqesë kërkesë për vazhdimin e afatit të Lejes me një arsyetim relevant por pa pasur nevojë të dorëzojë sërish dokumentacionin përcjellës.
4. Zgjatja e vlefshmërisë bëhet edhe për një periudhë shtesë prej një (1) viti, pa të drejtë të vazhimit tjetër.

Neni 11 **Regjistri i Lejeve**

1. Komuna mban një regjistër të Lejeve të lëshuara për instalimin e paneleve fotovoltaike për vetëkonsum, i cili përmban këto informata:
 - 1.1. Të dhënat e Aplikuesit;
 - 1.2. Data e lëshimit dhe vlefshmëria;
 - 1.3. Vendndodhja dhe kapaciteti i projektit;
2. Komuna mban komunikim të rregullt me Zyrën e Rregullatorit për Energji.

III. DISPOZITAT NDËSHKIMORE

Neni 12 **Gjobat**

Komuna në pajtim me Nenin 35 të Ligjit për Ndërtim (Ligji Nr. 04/L-110) mund të shqiptoj gjoba për personat fizik dhe juridik.

Neni 13
Zbatueshmëria

Kjo Rregullore është e zbatueshme për të gjithë personat fizik dhe juridik që ushtrojnë veprimtari në territorin e Komunës së Fushë Kosovës.

Neni 14
Implementimi dhe Mbikëqyrja

Për implementim të kësaj Rregullore përgjegjëse do të jenë *Drejtoria e Planifikimit Urban* dhe Drejtoria e Inspektionit.

IV. DISPOZITAT PËRFUNDIMTARE

Neni 15
Zgjidhja e kontesteve

Për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve lidhur me instalimet e paneleve fotovoltatike për vetëkonsum pas fazës së ndërtimit dhe dëmet eventuale që rezultojnë në mjedis dhe pronë kompetente është Gjykata Komerciale në Prishtinë.

Neni 16
Pajtueshmëria me Ligjin

Në rast të mospërputhjes së dispozitave të kësaj Rregulloreje me Ligjin për Vetëqeverisjen Lokale apo aktet të tjera të pushtetit qendror dhe në rastet e zbrazëtirave të tjera ligjore në këtë Rregullore, do të zbatohen drejtpërdrejt dispozitat e Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale nr. 03/L-040, deri në harmonizimin e këtij akti me legjislacionin përkatës.

Neni 17
Hyrja në fuqi

Kjo Rregullore hyn në fuqi pesëmbëdhjetë (15) ditë pas regjistrimit në Zyrën e protokollit të Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal, si dhe publikimit në gjuhë zyrtare në uebfaqen e Komunës.

Komuna e Fushë Kosovës

Date __, __, 2026.

Kryesuesi i Kuvendit Komunal

Vlonjat Hasani

Aneksi 1:



Aplikacioni për leje për instalimin e paneleve fotovoltaike (PV) për vetë-konsum

1. Informacionet rreth Aplikuesit		A është aplikuesi person i autorizuar? Jo ☐ Po ☐	
Emri		Nr. Personal	
Adresa			
Telefoni		☐	A dëshironi të ju kontaktojmë përmes telefonit apo përmes emailit ? (shënoni njërën)
E-mail		☐	

2. Detajet rreth objektit (vend ndërtimit) ku do të instalohen panelet fotovoltaike			
Adresa e vend ndërtimit (ose përshkrimi i lokacionit)			
Zona Kadastrale		Nr. I Parcelës Kadastrale	
Koordinatat e vendndodhjes GP – Kosova REF:			
Lloji i objektit	Shtëpi individuale ☐	Objekt afarist ☐	Hapësirë ndërtimore ☐
Kapaciteti i propozuar për instalim në kW			

3. Dokumentet e kërkuara	
1. Aplikimi/Kërkesa	
2. Kopja e dokumentit të identifikimit personal ose certifikatës së regjistrimit të biznesit të Aplikuesit;	
3. Flea poseduese;	
4. Kopje e planit me koordinata;	
5. Përshkrimi teknik i Projektit, duke përfshirë projektin elektrik	
6. Nëse Aplikuesi nuk është pronar ligjor, një kontratë për shfrytëzimin e ngastrës ose	

dëshmi se ka titull ligjor për të shfrytëzuar pronën.	
7. Pelqimin Mjedisor nga MMPH- për kapacitete prodhuese mbi 100 KW/ore	
8. Lejen Mjedisore Komunale për kapacitete prodhuese deri ne 100 KW/Ore	
9. Nëse objekti ku propozohet instalimi nuk ka leje ndërtimi, dëshmi për paraqitjen e kërkesës për legalizim	

4. Deklarata e aplikuesit:

Përmes kësaj unë aplikoj për leje për instalimin e paneleve fotovoltaike për vetë konsum sipas përshkrimeve në këtë formular dhe projektin e bashkëngjitur, skicat dhe informatat shtesë. Konfirmoj se sipas dijenisë sime më të mirë të gjitha faktet të paraqitura në këtë aplikacion janë të vërteta dhe të sakta dhe punët ndërtimore të propozuara janë në përputhje me kushtet e ndërtimit dhe me Kodin Unik të Ndërtimit të Republikës së Kosovës.

Emri mbiemri dhe nënshkrimi i Aplikuesit	Data (dd/mm/vvvv)

5. Deklarata e aplikuesit për objekte pa leje ndërtimi³

Unë gjithashtu me përgjegjësi materiale deklaroj se objekti në të cilin propozohet instalimi i paneleve fotovoltaike nuk ka leje ndërtimi dhe se kam iniciuar procesin e legalizimit, po ashtu deklaroj se marr përsipër çdo pasojë dhe dëm në rast të shkaktimit të dëmit si rrjedhojë e vendosjes së Paneleve fotovoltaike në objektin i cili nuk posedon Leje Ndërtimi.

Emri mbiemri dhe nënshkrimi i Aplikuesit	Data (dd/mm/vvvv)